



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.16/2011
Prishtinë, më 14.06.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostić.

Munguan : Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZPRK; Haxhi Gashi-USAID/ Deloitte; Lejla Selimi- OSBE dhe Ervin Ibrahimimi - UNDP.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet te datave 07 dhe 08.06.2011;
3. Miratimi i Raportit me Rekomandime te Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare;
4. Miratimi i Raportit me Rekomandime te Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim;
5. Miratimi i Planit kombëtar te shpërndarjes se spektrit radiofrekuencor;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet te datave 07 dhe 08.06.2011

Procesverbalet nga mbledhjet te datave 07 dhe 08.06.2011 u miratuan pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit me Rekomandime te Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare

Kryetari – theksoj se Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për shoqëritë tregtare, është kthyer pa ndonjë vërejtje nga komisionet përhershme, përveç komisioni për legjislacion, ku thuhet që Amendamentet 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 janë krejtësisht të paqarta. Ndërsa Amendamentet 5 dhe 6 janë në mospajtim me rregullativën juridike për llogaritjen e afateve, sepse me këtë rregullativ nuk është përcaktuar llogaritja e afateve me ditë pune. Po ashtu në amendamentin 6 afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh për iniciimin e kontestit administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës është në mospajtim me LKA-në. Pastaj shtoj se pasi që Njësia e mbështetse e komisionit i ka marrë për baze këto vërejtje te komisionit për legjislacion, pas këtyre korgjimeve procedurale, duhet të miratohet dhe të procedohet në mbledhje plenare për lexim të dytë.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare.

4. Miratimi i Raportit me Rekomandime te Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim

Kryetari – theksoj që edhe te Raporti me Rekomandime te Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim, kemi një miratim nga Komisionet e përhershme, ku është kthyer pa ndonjë vërejtje, përveç Komisionit për legjislacion ku ka paraqitur vërejte vetëm te Amendamenti 6 i Komisionit Funksional, ku theksohet që është në kundërshtim me Ligjin e Gazetës Zyrtare. Ne vazhdim kërkoj nga Njësia e mbështetse e Komisionit që te evitohet Amendamenti 6 sipas rekomandimit te Komisionit për Legjislacion, duhet të miratohet dhe të procedohet në mbledhje plenare për lexim të dytë.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim.

5. Miratimi i Planit kombëtar te shpërndarjes se spektrit radiofrekuencor

Kryetari - theksoj se tanime kemi shtetur debatin per këtë çështje pasi qe jave e kaluar me datë 10 qershor organizuam edhe Dëgjim publik, ku kishte mjaftë palë të interesuara për Planin kombëtar për shpërndarjen e radiofrekuencave. Ne fund kërkoj të miratohet ky Plan, sepse është interes shtetëror i Kosovës.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Plani kombëtar i shpërndarjes se spektrit radiofrekuencor.

dhe Kuvendit i parashtrohet këtë:

Rekomandim

- 1. Të miratohet Plani kombëtar i shpërndarjes se spektrit radiofrekuencor.*
- 2. Arsytimin e Raportit me rekomandime e paraqet, kryetari i Komisionit Zenun Pajaziti.*

5. Të ndryshme

b)Aktivitet e radhës te Komisionit;

Kryetari – kërkoj nga anëtarët e Komisionit që kur te kemi vizita puna në bazë të Planit të punës neper institucionet, që te jemi te koordinuar ma mire dhe te mos mungojnë paarsye ne aktivitete te Komisionit.

Ramiz Kelmendi - propozoj që të organizohet një takim nga Komisioni, lidhur me mundësin e rishikimit të ndryshimit të legjislacionit për politikën doganore, për lehtësimin doganor të lendeve të para për prodhimet vendore dhe stimulimin produkteve vendore bujqësore. Dhe te ftohën përfaqësuesit nga ministria e Financave, Bujqësisë dhe Tregtisë dhe Industrisë qe te raportojnë në Komision. Shtoj me tej se të filloj kjo iniciative, pastaj gjatë diskutimit më akteret apo palët do ta shikojmë së çka mund të ndryshojmë te ligjet që kanë të bëjnë më këtë sektor.

Hashim Deshishku - tha që nga fillimi i punës te këtij Komisioni kam kërkuar që të bëhet rishikim i politikave doganore për prodhuesit vendore dhe për simulimin e bujqësisë, prandaj e përkrahu këtë iniciative.

Fikrim Damka - tha që ka një subvencion nga ministria e Bujqësisë për fermerët për mbjelljen e tokave me grurë deri ne 30% të shpenzimeve ju mbulohen prej ministrisë së Bujqësisë.

Teuta Sahatqija - propozoj që për këtë çështje të organizohet një konferencë ku do të ftohën të gjitha palët që kanë të bëjnë më këtë fushë, duke përfshirë dhe shume shoqata të prodhuesve vendor, dhe shoqërinë civile që merren me këtë sektor.

Lutfi Zharku - tha së për këtë çështje duhet të behën analiza të mirëfillta, së ku janë pengesat që e pengojnë zhvillimin e ekonomik, pastaj të shikohet së ne cilat ligje duhet të ndryshohen dhe ku janë pengesat për prodhuesit vendore dhe për cilat produkte bujqësore mund t'i stimulojmë.

Myzejene Selmani - tha çdo iniciative është e mire por duhet te jetë një fazë e fizibilitetit, se çka mundemi më ndryshuar. Dhe kësaj çështje duhet ti paraprij mire me analiza duke përgatitur dhe një plan i veprimit dhe te dalim si komisioni funksional me kërkesa të qarta.

Kryetari - theksoj së kjo ide fillestare është e mire së ardhur, ndërsa për organizmin e një konferencë do konsultohemi me partneret tonë që na mbështesin, për ta shikuar mundësinë së çka mund të bëjmë në këtë drejtim.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

Të bashkëpunohet ngushte me institucionet përkatëse dhe shoqërinë civile, që të behet një planifikim dhe analize e mirëfillte për ligjet që përfshijnë sektorin politikave doganore për prodhuesit vendore dhe për stimulimin e bujqësisë.

b) Mbledhja e radhës

Kryetari – propozoj që në mbledhjen e radhës si pike rendit të ditës të jetë: Raportimi i Ministres së Tregtisë dhe Industrisë për marrëveshjen e CEFTA- së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit